

VENDIM
Nr. 101, datë 5.8.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË TAP AG PËR CERTIFIKIM SI OPERATOR I PAVARUR I
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR**

Bazuar në nenin 9, të ligjit nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, “Rregullat për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, të miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015 të Bordit të ERE-s, Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*, miratuar me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nenet 7 dhe 149 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Traktatit të Komunitetit të Energjisë të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, si dhe në përputhje me direktivën 2009/73-EC dhe rregulloren EC nr. 715/2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.8.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e TAP AG për certifikim si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror, si dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punës për shqyrtimin e këtij aplikimi,

dhe konstatoi se:

- Në datë 1 korrik 2015, TAP AG ka paraqitur në ERE kërkesën nr. 12/11 prot, datë 6.7.2015, dhe dokumentacionin përkatës i cili është gjithashtu i aksesueshëm edhe në *data room*-in e krijuar për qëllim të certifikimit si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror në përputhje me piken 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*, miratuar me vendimin nr. 64, datë 13.06.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

- Kjo kërkesë dhe dokumentacioni i paraqitur në ERE, është vënë gjithashtu në dispozicion të autoriteteve RAE dhe AEEGSI si pjesë e gjithë dokumentacionit të nevojshme për procedurën e certifikimit nga tre rregullatorët e vendeve ku kalon projekti TAP përkatësisht Greqi, Shqipëri dhe Itali.

- Paragrafi 4.5 i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*) vendos përjashtimin e TAP AG nga rregullat mbi ndarjen e pronësisë sipas nenit 9, pika 1 e direktivës 2009/73/EC për një periudhë 25 vjet duke filluar nga vendosja në përdorim e infrastrukturës;

- Paragrafi 4.5, pika 2 e Opinionit të Përbashkët Përfundimtar (*Final Joint Opinion*) kërkon që TAP AG të certifikohet si operator i pavarur i transmetimit për gazin natyror para fillimit të ndërtimit të infrastrukturës dhe jo me vonë se data 1 janar 2018.

- ERE në cilësinë e autoritetit përgjegjës për rregullimin e sektorit të gazit natyror dhe në përputhje me detyrimet sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë ratifikuar me ligjin nr. 9501 datë 3.4.2006, ka miratuar me vendimin nr. 100, datë 5.8.2015 “Rregullat për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë TAP AG për certifikim si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror.

2. Të sigurojë, brenda këtyre procedurave një ndërveprim me RAE dhe AEEGSI, me qëllim miratimin e një vendimi të përbashkët për certifikimin e TAP AG sipas modelit ITO në përputhje me dispozitat e kapitullit IV të direktivës 2009/73/EC, me përjashtim të nenit 22 të kësaj direktive, siç parashihet me nenin 4.5, paragrafi 2 i Opinionin të Përbashkët Përfundimtar.

3. Ky vendim i njoftohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Autoritetit të Konkurrencës dhe TAP AG.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti